



ME
 Nr. 18 - 07 - 20 - 18

P.nr. 1777/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRERGJITHSHËM, Divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren Hysnije Gashi si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Albina Varoshi, në çështjen penale kundër te akuzuarit [REDACTED] për shkak te veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1te KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.60-5/16 të dt. 17.07. 2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.12.10.2017 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr.60-5/16 të dt. 17.07. 2017dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED] nga i ati [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj, rr. [REDACTED], i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11.01.2016 rreth orës 16:45, në afërsi të shkollës ‘Vezir Jashari’ në rrugicën që të qon tek varrezat e qytetit të Ferizajt, duke drejtuar automejtin e markës ‘Audi A6’, ngjyrë hiri, me targa të regjitstrimit [REDACTED] nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që nukka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, ku në përfundim të rrugës nuk ks mundur ta ndal automjetin ashtu që i godet rrethojat e varrezave ku përveç dëmeve materiale në automjet Indime të lehta trupore pëson [REDACTED] të përshkruara si në ekspertizën mjeko- ligjore të dt.01.07.2017.

Me te cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 e KPK-së.

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurin me dënim me gjobë në shumë prej 200 €, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

- Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.
- I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj rr [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Konform nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguajë shumën prej 20€ si dhe shpenzimet për ekspertize te komunikacionit ne vlerë prej 90.88 € në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.60-5/16 të dt. 17.07. 2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.60-5/16 të dt. 17.07. 2017, me arsyetim se ka

prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj rr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Konform nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguajë shumën prej 20€ si dhe shpenzimet për ekspertize te komunikacionit ne vlerë prej 90.88 € në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.


Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1777/17 dt.12.10.2017

**Bashkëpunëtore profesionale,
Albina Varoshi**

**Gjyqtarja,
Hysnije Gashi**



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.